



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 240/2 Prot.

Tiranë, më 16 . 09 . 2015

V E N D I M

Nr. 100 Datë 16 / 09 2015

**Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil,
në Ministrinë e Kulturës**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe të Rregullores "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin, Ministria e Kulturës,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 15, datë 11.03.2015 "*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Ministrinë e Kulturës*", është urdhëruar të fillojë mbikëqyrja e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Ministria e Kulturës.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe ka përfshirë monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe akteve nënligjore, për të gjithë institutet e tij.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt filloi në datë 17.03.2015, sipas programit të mbikëqyrjes të miratuar nga Komisioneri nr. 240/2 prot., datë 11.03.2015, njoftuar institucionit me shkresën nr. 240/1 prot., datë 11.03.2015 "*Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes*".

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e

shërbimit civil, dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 240/3, datë 23.06.2015 *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Ministrisë së Kulturës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresën nr. 240/4 prot., datë 23.06.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Ministrisë së Kulturës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje Departamentit të Administratës Publike.

Institucioni i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes me shkresën nr. 3619 prot., datë 14.07.2015 *“Kërkesë për shtyrje afati të përgjigjes për projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në Ministrinë e Kulturës”*, ka kërkuar shtyrjen e afatit të caktuar për paraqitjen e observacioneve. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 240/6 prot., datë 16.07.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil *“Njoftim për shtyrje afati të paraqitjes së observacioneve”*, institucioni është njoftuar për shtyrjen e afatit për paraqitjen e observacioneve deri në datën 30 korrik 2015.

Në vijim të procesit, Ministria e Kulturës me shkresën nr. 3956 prot., datë 30.07.2015 *“Mbi pretendimet dhe sqarimet në lidhje me “Projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin e Ministrisë së Kulturës, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, ka kthyer pranë Komisionerit, projektraportin e nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe nëpunësi përgjegjës për administrimin e burimeve njerëzore në institucion, së bashku me observacionet përkatëse në lidhje me konstatimet e grupit të mbikëqyrjes.

Nga ana e Komisionerit u analizua përmbajtja e observacioneve, si dhe e akteve që i shoqërojnë ato, u krahasuan me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, të evidentuara në projektraport dhe qendrimi në lidhje me to, është materializuar në pjesët përkatëse të raportit.

Në përmbajtjen e observacioneve të paraqitura nga institucioni pretendohet se është reaguar në lidhje me disa parregullsi të evidentuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, të cilat kanë të bëjnë me miratimin dhe dokumentimin e përshkrimeve të punës, statusin e disa nëpunësve në përfundim të periudhës së proves; përfundimin e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014 dhe plotësimin e dosjeve të nëpunësve civilë me dokumentet që vërtetojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe plotësimin e kërkesave të posaçme të vendit të punës.

Por, nisur nga aktet administrative bashkëlidhur observacioneve konstatohet se kjo situatë është përmirësuar vetëm për një pjesë të konstatimeve dhe në këto kushte, verifikimi i përmbushjes së këtyre detyrave, në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, pas miratimit të raportit përfundimtar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe Rregulloren *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në Ministrinë Kulturës, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, për nëpunësit dhe punonjësit, të cilët u gjenden në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit të ri, sipas kërkesave të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.
3. Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, të formalizojë procesin e hartimit të përshkrimit të punës, nëpërmjet,
 - një raporti me shkrim mbi fillimin, ecurinë dhe përfundimin e procesit nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore;
 - të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin e miratuar, së bashku me opinionet përkatëse, lidhur me bashkëpunimin e realizuar me njësinë e burimeve njerëzore; dhe pas kësaj,
 - të realizojë miratimin e përshkrimeve të punës, nënshkrimin e tyre dhe dokumentimin, duke i depozituar më pas pranë Departamentit të Administratës Publike.
4. Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, në përmbushje të detyrimeve ligjore, si dhe të rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në përmbajtjen e raportit, duhet të marrë masat për të bërë të mundur verifikimin e përmbajtjes dhe procedurës së ndjekur për hartimin e formularit të

përshkrimit të punës, dokumentimin e këtij procesi dhe më tej, për të administruar këtë formular, në materialet përkatëse, të cilat ruhen pranë arkivës së tij.

5. Njësia e burimeve njerëzore, duhet të përfundojë procesin e konfirmimit për nëpunësit, të cilëve i ka përfunduar periudha e provës, duke vepruar në këtë mënyrë:
 - Të përfundojë procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.
 - Momenti i vlerësimit të punës duhet të llogaritet duke filluar nga data e daljes së aktit të emërimit të nëpunësit civil, për rastet kur nëpunësi ka filluar punë nëpërmjet procedurave të konkurrimit, sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” dhe në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit (26.02.2014), për rastet që nuk ishte përmbushur periudha e provës (1 vit).
 - Momenti i vlerësimit të punës, për punonjësit që kanë qenë në marrëdhënie pune kontraktuale në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, duhet të përkohë me përfundimin e periudhës së provës, që në këto raste fillon në datën 26.02.2014.
 - Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës, për të gjithë punonjësit që e përfundojnë atë, sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - Të administrohet në dosjen e personelit, rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASP), si dhe çertifikata e lëshuar në këtë rast prej këtij institucioni.
 - Procesi duhet të përfundojë me vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës, për secilin nëpunës që trajtohet sipas procedurave të mësipërme.
 - Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, të përfshihet evidentimi i bazës ligjore ku mbështetet procesi, si dhe të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin, datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013, të evidentohet në akt, numri dhe data e dokumentit të përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit, pranë Shkollës së Administratës Publike (ASP).
6. Nga ana e njësisë së burimeve njerëzore, duhet të përfundojë procedura e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2014, për ata nëpunës, për të cilët procedura ishte në proces, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, sipas rekomandimeve të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.

7. Të plotësohet dosja e personelit me të gjitha dokumentet e evidentuara si në mungesë, në tabelat aneks, bashkëlidhur këtij raporti, sipas rekomandimit në raportin e mbikëqyrjes.
8. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
9. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Ministria e Kulturës, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
10. Për këtë vendim të njoftohet Ministria e Kulturës dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA